



Centre for Legal
Empowerment

www.cle.al

2022

ZYRAT E KARRIERËS

►► Sindi Çausi
Borana Fuqi
Endi Kalemaj



PASQYRA E PËRMBAJTJES

- 01** **Abstrakt**
- 02** **Baza ligjore ekzistuese**
- 03** **Vëzhgim në Universitetin e Tiranës**
 - ▶ Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS)
 - ▶ Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN)
 - ▶ Fakulteti i Ekonomisë (FEUT)
 - ▶ Fakulteti Gjuhëve të Huaja (FGJH)
 - ▶ Fakulteti i Drejtësisë (FDUT)
- 04** **Vëzhgim në Universitete Europiane**
 - ▶ "University of Edinburgh", Edinburg, Skoci
 - ▶ "Central European University", Vienë, Austri
- 05** **Sugjerime për fakultetet vendase**
- 06** **Përfundime**

ABSTRAKT

Ndër vështirësitë që kanë studentët në jetën akademike mund të përmendim ambientimin në fakultete; orientimin mbi strukturën organizative; njohjen me programin mësimor; orientimin në tregun e punës; mënyrën për të shkruar CV dhe letër motivimi; orientimin për trajnimet dhe për shumë problematika të tjera, pika këto, të cilat janë edhe ndër angazhimet kryesore të zyrave të karrierës, zyra të cilat ndodhen pranë çdo institucioni arsimor universitar dhe jo vetëm.

Zyrat e Karrierës ndihmojnë studentët të arrijnë potencialin e tyre të plotë përmes zhvillimit personal, përparimit akademik dhe përgatitjes për hapat vijues pas diplomimit. Ato nxisin studentët të shfrytëzojnë kohën e tyre në mënyrë sa më efektive dhe mbi të gjitha aspektet e jetës në universitet. Zyra e karrierës asiston studentët që të eksplorojnë mundësitë e karrierës dhe kështu, ata afrohen më shumë me tregun e punës.

Duke parë parimisht këtë mungesë në fakultetet vendase, u pa e arsyeshme për të studiuar mbi këtë temë sa të rëndësishme, aq dhe vendimtare për të ardhmen. Ky punim, duke synuar krijimin e një analize të plotë mbi zyrat e karrierës, është fokusuar si në modelet e fakulteteve vendase dhe ato ndërkombëtare, duke realizuar dhe krahasimet përkatëse. Nëpërmjet monitorimit online dhe fizikisht kuptuam qartazi punën që kryejnë dhe me çfarë vështirësish hasen disa prej tyre. Studimi është realizuar në Universitetin e Tiranës në të gjitha Fakultetet e tij si dhe në dy Universitete të huaja. Në vijim do të paraqiten informacione për funksionimin e Zyrave të Karrierës në secilin fakultet, si dhe propozime për mënyrën e rregullimit të tyre, nëpërmjet analizës së përgjithshme të modeleve të marra në konsideratë.



BAZAT LIGJORE EKZISTUESE

Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3, parashikon se institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike dhe autonomi financiare e organizative. Neni 3 pika 4/a mundëson liri në organizimin e strukturës së tyre të brendshme dhe përzgjedhjen e personelit, vetëqeverisje dhe rregullim të ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të brendshme, të hartuara në përputhje me ligjin e sipërcituar dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore në fuqi. Pas një leximi të detajur të ligjit në fjalë, do të shohim se nuk kemi asnjë dispozitë referuar drejtpërdrejtë Zyrave të Karrierës.

Nëse realizojmë një interpretim të zgjeruar dhe ndalemi specifikisht tek Neni 23[1], Neni 33 pika 4 [2] dhe Neni 36[3] do të shohim se kjo strukturë i lihet çdo fakultetit në parashikimet e tij të brendshme, pasi mund të përfshihet lehtësisht në njësitë përbërëse të tij, duke qënë se qëllimi që ajo mbart përfshihet në misionin dhe objektivat që këto institucione arsimore synojnë të arrijnë. Për të kaluar më pas në një dokument të rëndësishëm të Universitetit të Tiranës, rregullorja e UT, e miratuar me Vendim nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, ndryshuar (për herë të fundit) me vendimet e senatit akademik nr. 26 datë 02.07.2015, e cila nuk parashikon në strukturat e fakulteteve përkatëse krijimin e Zyrave të Karrierës. Përsëri shohim se ky parashikim i lihet strukturave të brendshme të Fakulteteve të UT, të cilat duhet ta parashikojnë në organizimin e përvitshëm. Në rregullore[4] përcaktohet qartë struktura e secilit prej fakulteteve dhe për zyrat e karrierës/struktura të tjera, një parashikim i tillë për zgjerim, është në mundësinë e secilit fakultet përmes një vendimi dekanati.

[1] Neni 23 Fakulteti Pika 3. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

[2] Neni 33 Statuti dhe rregullorja e institucioneve të arsimit të lartë pika 4. Në statut, në përputhje me këtë ligj dhe me vendimin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, përcaktohen hollësisht: organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhja apo emërimi i tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit

[3] Neni 36 Organet dhe autoritetet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë

6. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të krijojnë në strukturën e tyre autoritete dhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e institucionit, sipas përcaktimeve në statutin e tyre

[4] Rregullore nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, ndryshuar me vendimet e senatit akademik nr. 26 datë 02.07.2015.

Pas një vlerësimi të web-site-ve përkatëse të fakulteteve përbërëse të Universitetit të Tiranës, mund të themi se:

- Fakulteti i Drejtësisë
- Fakulteti i Histori-Filologjisë
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Fakulteti i Ekonomisë

nuk kanë një rregullore të brendshme por referojnë në rregulloren e pëgjithshme të UT. Përmendim këtu se Fakulteti i Drejtësisë dhe ai i Ekonomisë parashikojnë “një dritare” nën titullin Zyra e Karrierës ose Qendra e Karrierës, por fatkeqsisht me shumë pak, ose aspak, informacion të përmbajtur në të.

Ndryshe paraqitet faqja web e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të cilat sigurojnë elektronikisht për lexuesit rregulloren e tyre të brendshme dhe parashikojnë dispozita specifike [1] për shërbimet e karrierës. Në web faqen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja parashikohet për Zyrat e Karrierës [2]:

“

“Zyra e Këshillimit të Karrierës ka në fokus të saj nxitjen e bashkëpunimit me studentët dhe synon të realizojë lidhjen mes studimeve akademike dhe mundësive të punësimit për studentët e diplomuar në FGJH. Kjo zyrë u krijon atyre mundësi të promovohen në kompani, organizata si edhe shoqata të ndryshme të interesuara për punëmarrës. Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon dhe monitoron Praktikën Profesionale dhe Panairin e Punës, si dhe udhëzon studentët për zhvillimin në karrierë, duke u përqëndruar në interesat personale të studentëve, si dhe harmonizimin e tyre me kërkesat për punësim në tregun e punës.”

”

[1] Rregullore e FGJH , Neni 21 Këshillimi I Karrierës

[2] web:<https://fgjh.edu.al/> Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Në shërbimet e saj, Zyra e Këshillimit të Karrierës së FGJH parashikon se ofron:

- Workshope;
- Trajnime;
- Ditë të Hapura (Open Day);
- Panaire Pune;
- Takime të Hapura.

Gjithashtu Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon leksione të hapura me tematika të ndryshme si:

- Krijimi i një CV-je;
- Si të shkruajmë një Letër Motivimi;
- Përgatitja për intervista pune, etj.

Përmendim se Fakulteti i Shkencave Sociale, përpos rregullores së brendshme, parashikon edhe një rregullore specifike mbi Shërbimet e Karrierës. [1] Në mënyrë të qartë dhe të mirëpërcaktuar, kjo rregullore parashikon shërbimet që ajo ofron dhe instrumentat me anë të së cilës ajo realizon misionin e saj. Në faqen web të këtij fakulteti, për Shërbimet e Karrierës parashikohet [2]:

“

“Shërbimi i karrierës i Fakultetit të Shkencave Sociale është një strukturë që nëpërmjet shërbimeve që ofron i ndihmon studentët të përgatiten për të ardhmen. Vizioni i Shërbimit të karrierës është të frymëzojë dhe të mbështesë çdo student aktual dhe të diplomuar të FSHS-së që të zhvillojë plotësisht potencialin e tij për një karrierë të suksesshme. Shërbimi i karrierës ka si mision që nëpërmjet informimit, orientimit, këshillimit, trajnimit të mbështesë studentët ndërsa studiojnë në FSHS dhe pas diplomimit që të shfrytëzojnë potencialet e tyre për zhvillimin e karrierës individuale, të bëjnë zgjedhje të përshatshme arsimore, të arrijnë sukses akademik, të orientohen në tregun e punës, të konkurrojnë me sukses në tregun e punës dhe të menaxhojnë me sukses karrierën gjatë gjithë jetës.”

”

[1] Për më tepër shih “Rregullore e Shërbimit të Karrierës” miratuar nga Dekanati I FSHS në 2020

[2] Faqja web e FSHS https://fshs-ut.edu.al/?page_id=9206

Fakulteti i Shkencave Sociale parashikon se shërbimet që ofrohen janë të shumëllojshme, ku ndër to renditen:

- informim për karrierën;
- orientim për karrierën;
- këshillim për karrierën;
- trajnim për zhvillimin në karrierë;
- informim dhe asistencë për aplikim për programet e studimit;
- asistencë për praktikën profesionale;
- informim për mundësinë e arsimimit të mëtejshëm dhe zhvillimin profesional; asistencë për veprimtaritë e studentëve dhe të diplomuarve;
- informim dhe orientim për tregun e punës.

Një nga shërbimet që parashikohet që ofrohet, të cilin duhet ta thescojmë se nuk e kemi hasur në fakultetet e tjera është “Ditët e informimit të maturantëve”, një aktivitet i cili ka për synim të informojë maturantët për ofertën akademike të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe t’u shpjegojë atyre avantazhet e zgjedhjes së programeve të studimit që ofron ky fakultet. Për më tepër, çdo departament ka përgatitur nga një broshurë informuese pse duhet të zgjedhin departamentin në fjalë dhe mundësitë e punësimit që ofrohen.

Pjesë e Shërbimit të Karrierës në FSHS parashikohen të jenë edhe klubet studentore:

“Shërbimi i karrierës mbështet studentët të organizohen në klube studentore dhe nëpërmjet veprimtarive të ndryshme të pasurojnë formimin e tyre, ta bëjnë më të larmishme jetën studentore, të zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe të zhvillojnë aftësitë krijuese. Studentët kanë mundësi të organizohen në këto klube: Klubi i filozofit, Klubi i psikologut, Klubi i sociologut, Klubi i debatit, Klubi i vullnetarëve, Klubi i drejtësisë sociale.”

Rezulton se Fakulteti i Shkencave Sociale nuk ka lënë pas edhe lidhjet me studentët e diplomuar. Shërbimi i karrierës në FSHS mban lidhje me të diplomuarit, mbledh të dhëna për punësimin e tyre dhe suksesin në karrierë. Përpos të dhënave, në faqen web paraqiten edhe histori sukseesi të Alumni, duke paraqitur modele tepër pozitive për studentët e rinj ose maturantët.

Faktet e mësipërme janë një pasqyrim se çfarë ne shohim nga një kontroll rutinë i faqeve web të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës, por si rrjedhojë e punimit, ishte e nevojshme dhe duhej të shihnim më nga afër jo vetëm punën e Zyrave të Karrierës, por edhe vështirësitë, problematikat dhe frekuentimin e tyre. Në korrik 2022 vendosëm të komunikojmë në mënyrë zyrtare me Rektoratin me shkresë, më datë 20.07.2022 në lidhje me Zyrat e Karrierës në Universitetin e Tiranës, ku jemi informuar se:

“Në të gjitha Fakultetet e Universitetit të Tiranës janë të miratuara strukturat (zyrat) e Karrierës. Përjashto Fakultetin e Drejtësisë, i cili aktualisht është në proces për rekrutimin e personelit në këtë zyrë. Në të gjitha fakultetet e tjera të Universitetit të Tiranës, zyrat janë funksionale.”

Me kthimin e përgjigjes nga Rektorati i Universitetit të Tiranës, monitorimi është shtrirë në të gjitha fakultetet e UT, konkretisht, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

VËZHIM NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në këtë fazë, pas monitorimit online, u pa si e nevojshme monitorimi në terren dhe u morën në konsideratë 4 fakultete të Universitetit të Tiranës.

1. Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS)



2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN)



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave të Natyrës

3. Fakulteti i Ekonomisë (FEUT)



4. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FSHH)



5. Fakulteti i Drejtësisë (FDUT)



Si fillm, çdo fakulteti iu dërgua një email, ku kërkonim informacion mbi zyrat e karrierës. Konkretisht pyetjet që u janë dejtuar janë si mëposhtë:

- 1) Në fakultetin tuaj a ndodhet një zyrë karriere?
- 2) Nëse po, a është funksionale kjo zyrë?
- 3) Rregullimi i zyrës së karrierës në fakultetin tuaj, me çfarë akti është realizuar?
- 4) Nëse do të jetë e mundur, a mund të konsultohemi me aktin?
- 5) Prej sa kohësh operon kjo zyrë?
- 6) A keni raporte duke krahasuar periudhën në të cilën ishin funksionale me periudhën kur nuk kanë ekzistuar, dhe çfarë impakti ka sjellë?
- 7) Nëse keni bilance, cilët janë target group (studentët e vitit të parë, studentët e viteve të fundit), të cilët interesohen dhe paraqiten pranë kësaj zyre?
- 8) Nëse keni një program dhe aktivitete përkatëse të cilat realizohen nga kjo zyrë, nëse do jetë e mundur, mund të na i vini në dispozicion?
- 9) Cilët janë personat përgjegjës të cilët punojnë pranë kësaj zyre?
- 10) A keni një bashkëpunim dhe ndërveprim midis vetë studentëve, pra a keni aktivizuar edhe student të cilët punojnë pranë këtyre zyrave?

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE (FSHS)

Në datën **26.07.2022** FSHS iu dërgua një email për të marrë informacione në lidhje me Zyrat e Karrierës dhe me anë të emailit morrëm informacioni e kërkuar. Informacioni erdhi më datë **7/09/2022**. Gjatë fazës së monitorimit fizik në këtë institucion konstatuam se ka një zyrë karriere, dhe ajo është funksionale, që prej vitit 2020. Si rezultat i monitorimit në Fakultetin e Shkencave Sociale, mund të shprehemi që ishte një ndër fakultetet më bashkëpunues dhe të gatëshm për t'u përgjigjur çdo pyetjeje të ngritur nga ne.

Zyra e karrierës pranë Fakultetit të Shkencave Sociale është **krijuar me vendim Dekanati** dhe ka një rregullore të sajën që prej vitit 2020, me vendim të dekanit. Në të rregullohet organizimi dhe shërbimi i karrierës, vizioni dhe misioni, shërbimet, detyra të shërbimit të karrierës, instrumentet për shërbimin e karrierës, dhe dokumentacioni i shërbimit të karrierës. Me vendim të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale më 2020, janë krijuar edhe politika për mbështetjen e studentëve dhe të strukturave të tyre organizative. Këto objektiva kryesore, të cilat paraqiten dhe në mbështetje të zyrave të karrierës janë: mbështetja e FSHS-së për studentët si një përgjegjësi institucionale, vlerësimi i qasjes së studentëve ishte në qëndër të veprimtaris së FSHS-së, identifikimi i nevojave për mbështetje institucionale, problematikat që hasen me frekuentimin e studentëve dhe nevoja e bashkëpunimit më interaktiv me Zyrat e tjera të Karrierës. Disa nga shërbimet që ofron kjo Zyrë janë: orientim dhe këshillim për studentët për të përfituar aftësi praktike, informim për një mundësi të re studimi, përpilim dokumentash zyrtare, përpilim detyrash kursi apo diplomash, informacion rreth internshipeve të mundshme dhe mundësive të punësimit. Disa nga qëllimet janë këshillim i karrierës, orientim në tregun e punës, krijimi i lidhjeve mes studentëve dhe punëmarrësve potencialë, të shërbejë si burim rekrutimi për shumë organizata dhe institucione, të ofrojë shërbime trajnimi në bashkëpunim me kompani të ndryshme, të rrisë numrin e të diplomuarve në profesionin e tyre.

Nga ajo se çfarë është raportuar, nga vëzhgimet në terren, nga informacionet e siguruar në mënyrë zyrtare por edhe në rrugë operative vërehet një bashkëpunim midis Zyrës së Karrierës, studentëve dhe institucioneve të tjera. Pra në këtë Fakultet shikohet bashkëpunim i ngushtë midis të treja hallkave kryesore. Problemi i vetëm është ndërgjegjësimi që duhet të kenë studentët për tu informuar dhe për të pasur sa më shumë informacione mbi zyrat e karrierës dhe rendësinë e tyre.

FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS (FSHN)

Monitorimi vijoi me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të cilit i është dërguar email më datë 22/07/2022, ku kërkonim të njëjtin informacion mbi Zyrat e Karrierës, sikurse edhe për fakultetet e tjera. Me anë të e-mailit nuk na u dërgua asnjë përgjigje. Më datë 06/09/2022 i jemi drejtuar me shkresë në mënyrë fizike institucionit përkatës, por përsëri nuk arritëm të kemi një përgjigje në lidhje me zyrat e karrierës në këtë institucion. Me të njëjtën situatë u ndeshëm edhe në Fakultetin e Ekonomisë, ku u hasëm me një sjellje burokratike, mos kthim përgjigjesh dhe mos respektim afatesh kohore. Gjatë fazës së monitorimit në këto fakultete konstatoam se ka një zyrë karriere, e cila është funksionale, që prej vitit 2020. Nuk patëm informacione në rrugë zyrtare nga ana e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, dhe informacion është siguruar përmes web-it të Fakultetit dhe informacione të cilat kemi arritur të marrim në mënyrë operative në terren. Në datën 29 tetor 2013, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, është realizuar hapja e Zyrës së Karrierës për herë të parë, në bashkëpunim me partnerë si Ambasada Franceze dhe Agjencia Universitare e Farankofonisë. Përmes ngritjes së Zyrës së Karrierës, Universiteti i Tiranës synon të ndihmojë studentët dhe aktorët e tjerë të zhvillojnë potencialin e tyre për të qenë të suksesshëm në tregun e punës. Përmes shërbimeve të këshillimit të karrierës, mundësive të bursave, internship-ve të ndryshme, organizmit të aktiviteteve të ndryshme akademike dhe të ngjashme. Për periudhën 2013 dhe deri më 2018 nuk ka asnjë informacion nëse kjo zyrë ishte funksionale dhe nëse ka qenë e tillë si ka funksionuar. Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) e cila u krijua në shkurt të vitit 2020. Kjo degë është në varësi të Dekanit të FSHN dhe aktualisht operon me dy punonjës me kohë të plotë. Veprimtaritë e rregulluara për DSBCK, përpara periudhës së krijimit si strukturë më vete, janë zhvilluar nga Zyra e Karrierës, në respektim të kërkesave ligjore që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe këshillimin e karrierës. Në veprimtarinë e saj DSBCK, zbaton “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, mbështetur njëkohësisht në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumentave të Cilësisë”, miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23 Dhjetor 2020. Kjo strukturë ka një rol shumë të rëndësishëm sepse ajo vlerëson në mënyrë periodike efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative të institucionit. Kjo strukturë është e varur nga Dekani i Fakultetit, ku çdo vlerësim, monitorim dhe raport vjetor i njësisë dhe tërësia e veprimtarisë i dorëzohen Dekani në fund të vitit akademik.

Disa prej veprimtarive dhe aktiviteteve të kryera nga Zyra e Karrierës për vitin akademik 2020-2021 janë:

- Hartimi i modelit të syllabusit të lëndës.
- Janë grumbulluar dosjet me Planet Mësimore të çdo departamenti për vitet akademike 2020-2021.
- Janë grumbulluar dosjet me syllabuset e çdo departamenti për vitin akademik 2020-2021.
- Në fillim vitit akademik, DSBCCK ka zhvilluar takime, këtë vit online, për mënyrën e monitorimit dhe raportimit të çdo procesi, gjithashtu ka detyrimin që të bëjë raport me shkrim për çdo proces monitorimi apo vlerësimi. Këto takime kanë pasur si qëllim trajnimin e anëtarëve për mënyrat e monitorimeve për procese të ndryshëm si dhe shpërndarjen e model raporteve të përbashkët. Janë realizuar takime me studentët dhe pyetësorë për vlerësimin e cilësisë, në bazë të të cilëve janë organizuar trajnime me studentët.
- Janë realizuar vlerësime për ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga njësia kryesore, DSBCCK. Në bashkëpunim me Zv.Dekanin për Ciklin e Parë dhe të Dytë të FSHN-Së, është përgatitur programi për gjurmimin e studentëve të diplomuar si dhe formulari për informacionin që do të mblidhet në funksion të gjurmimit, në përputhje me Rekomandimin (2017/C 423/01) të Këshillit European si dhe Guidës së BE-së për llojin e informacionit që duhet mbledhur për gjurmimin e studentëve.
- Është propozuar “Kalendari i aktiviteteve ekstrakurrikulare të FSHN”. Ky kalendar parashikon të ofrojë udhëzime për përgatitjen për tregun e punës, mundësi për vijim e studimeve, aplikim për bursa apo mundësi punësimi. Kontaktimi me Zyrën e Karrierës mund të realizohet edhe në mënyrë elektronike për të kërkuar informacione mbi programin që ofron zyra. Është ofruar asistencë individuale për çdo student që i është afuar zyrës, për kërkesa për punësim që ka patur nga punëdhënës, për programe Erasmus, deri në asistencën për përgatitjen e dokumentave të nevojshme për aplikim për bursa studimi, gjenerim të shpejtë të dokumentave nga sekretarët mësimore, asistencë në informimin për studime dhe praktika profesionale.

Siguruar në rrugë operative, aktivitetet e realizuara nga Zyra e Karrierës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës janë:

1. **Njohja me ambientet** e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, për studentët e vitit të parë.
2. Mënyrat se **si të shkruajmë CV dhe letër motivimi**, (realizuar në periudhen shkurt-mars)- nuk ka të dhëna për numrin e pjesëmarrësve.
3. **Informim për “BURSA”** (realizuar në tetor-nëntor)- nuk ka të dhëna për numrin e pjesëmarrësve.
4. Prezantim për bursa projekti **“ERASMUS PLUS”** (dhjetor-janar) nuk ka të dhëna për numrin e pjesëmarrësve.

FAKULTETI I EKONOMISË (FEUT)

Përsa i përket FEUT nuk mundëm të marrim informacion, në lidhje me funksionimin e Zyrës së Karrierës, jo vetëm nëpërmjet kërkesës së informacionit në adresën e postës elektronike në **datën 26.07.2022**, ku nuk kishim një përgjigjeje, por gjithashtu edhe gjatë takimit me punonjësen përkatëse, e cila arsyetoi se informacioni i kërkuar nuk mund të jepej pa u konsultuar me përgjegjësën e Zyrës. Informacioni që ne kemi është vetëm pak informacion i publikuar në faqen zyrtare të FEUT.

Qendra e Karrierës, pjesë e strukturës së Universitetit të Tiranës, filloi të funksionojë në vitin 2010. Çfarë duam të theksojmë për FEUT, është se Zyra e parë e Qendrës së Karrierës u hap në këtë fakultet, me fillimin e vitit akademik, tetor 2012. Gjatë vitit akademik, QAL organizon një sërë aktivitete, të cilat janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me studentët:

- “Të njohim fakultetin”
- Shkolla Verore/Dimërore
- Takime të hapura
- Leksione të hapura
- Kampionati i Debatit
- Panairi i Karrierës
- “Të dhurojmë pak dashuri”
- Bussines Trip etj, duke u dhënë mundësi pjesëmarrjeje të gjithë studentëve të interesuar.

Çfarë na tërhoqi vëmendjen gjatë vëzhgimit të faqes web është se, qendra e karrierës ka si pjesë mjaft të rëndësishme të saj grupin e studentëve vullnetarë. Studentët janë pjesë mjaft aktive në organizimin e çdo aktiviteti, si edhe në propozimin e eventeve të reja. Nëpërmjet tyre, nxit qasjen pozitive ndaj punës vullnetare dhe i jep mundësi studentëve të përfitojnë eksperiencë mjaft të vlefshme. Studentët vullnetarë të degëve dhe viteve të ndryshme formojnë një rrjet kompakt të vullnetarëve të Qendrës.

“Energjia, pozitiviteti dhe gatishmëria e studentëve vullnetarë, bashkëpunimi i tyre me njëri tjetrin dhe qendrën, çojnë në suksesin në rritje të kësaj strukture. Kjo eksperiencë e shkëlqyer është trampolina më e mirë për të ecur të sigurt drejt një karriere të shkëlqyer me aftësitë ndërpersonale, akademike dhe profesionale të fituara. Sot, numërohen mbi 600 studentë vullnetarë të QAL.” [1]

[1] <https://feut.edu.al/studentet/qendra-e-karrieres/85-rreth-qendres>

Ndryshe nga fakultetet e tjera ku një pengesë në punën e tyre ishte mos frekuentimi i studentëve dhe mos intersimi i tyre në lidhje me aktivitet e zhvilluara, FEUT ka arritur të krijojë bashkëpunim mjaft të mirë me studentët. Kjo zyrë gjithashtu ka një bashkëpunim të mirë, në zhvillimin e aktiviteteve, me Zyrën e Këshillimit të Karrierës në Bashki, ku studentët e këtij fakulteti përfituan shumë shërbime të ofruara si: këshillime individuale, trajnime, orjentime profesionale, paraqitje dinjitoze të CV-së; mundësi për kryerjen e praktikave të punës etj. Theksojmë se një prej aktiviteteve më të rëndësishme të zhvilluara këtë vit prej Zyrës së Karrierës së FEUT, është **Panairi i Punës**, i zhvilluar më 28 Prill. Mbi 60 kompani pjesëmarrëse të sektorit bankar, konsulencës, telekomunikacionit, turizmit, transportit, shoqatat e biznesit, i prezantuan studentëve të Fakultetit të Ekonomisë: mundësi punësimi, internship-e, trajnime, bursa studimi etj. Gjithashtu një nga aktivitetet më interesante të zhvilluara nga ky fakultet është **“Të dhurojmë pak dashuri”**. Ky aktivitet konsiston në mbledhjen e ndihmave për familjet në vështirësi ekonomike, duke ua dhuruar këtyre familjeve me rastin e festave të fundvitit. Qindra studentë vullnetarë angazhohen në mbledhjen e dhurimeve nga studentë dhe familjet e tyre, nga stafi i universitetit, si edhe nga bashkëpunëtorë të Qendrës. Më pas bëhet shpërndarja e dhurimeve në familjet e identifikuar. [1]



FAKULTETI GJUHËVE TË HUAJA (FGJH)

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka një zyrë funksionale karriere, gjë që u pa dhe nga afër përmes statistikave që na u vunë në dispozicion mbi punën që ishte realizuar. Fokusi i kësaj zyre nuk është vetëm ndihmesa e studentëve në zhvillimin e potencialit të tyre për një qasje më të mirë në botë akademike, por shtrihej edhe në:

- Lidhjen mes studimeve akademike dhe mundësive të punësimit për studentët e diplomuar në FGJH,
- Krijimin e mundësive për tu promovuar në kompani, organizata si edhe shoqata të ndryshme të interesuara për punëmarrës,
- Organizimin dhe monitorimin e Praktikës Profesionale dhe Panairin e Punes,
- Udhëzimin e studentëve për zhvillimin në karrierë, duke u përqëndruar në interesat personale të studentëve,
- Harmonizimin e tyre me kërkesat për punësim në tregun e punës.

Veçantia në këtë Fakultet është **promovimi i jetës studentore** brenda FGJH-së nëpërmjet aktiviteteve kulturore, sportive, artistike, sociale dhe vullnetarizmit me anë të Klubeve Studentore, si dhe krijimin e një qendre për aktivitete jashtëkurrikulare, që do të nxisë studentët të shpenzojnë më shumë kohë pranë kampusit studentor dhe të gjejnë mbështetje brenda FGJH-së për orientime lidhur me zhvillimin e tyre në karrierë dhe aftësive të punësimit, në një mënyrë që është e arritshme për të gjithë studentët, gjatë gjithë kohës së tyre të studimit.

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit në FGJH, mbështet dhe nxit përfshirjen e studentëve në jetën universitare përmes klubeve studentore dhe ngjarjeve akademike e sociale, duke i drejtuar ata në pjesëmarrje të klubeve. Sa më shumë aktivitete dhe sa më e lartë pjesëmarrja e studentëve, kjo do të ishte një arritje e mirë e objektivave të çdo Zyre Karriere, në çdo fakultet. Gjithashtu promovimi i aktiviteteve në rrjetet sociale do të ndihmonte në informimin e studentëve dhe do të stimulonte frekuentimin e tyre.

FAKULTETI I DREJTËSISË (FDUT)

Përmes kërkesës për informacion drejtuar rektoratit të UT u njoftuam se:

“Fakulteti i Drejtësisë ka në sturukturën e vetë Zyrën e Karrierës, por aktualisht është në proces për rekrutimin e personelit në këtë zyrë.”

Ndërkohë gjatë vëzhgimit fizik në Fakultetin e Drejtësisë (FDUT), ku u zhvilluan dhe takime me dekanen e këtij fakulteti, Prof.Asoc.Dr. Dorina Hoxha, mundëm të sigurojmë këto informacione:

- 1.FDUT nuk ka një zyrë karriere funksionale, pikërisht për arsyen e shpjeguar nga përgjigja e rektoratit të UT.
- 2.Dekania e këtij fakulteti, gjatë bashkëbisedimeve, pohoi se fakulteti po kërkon punonjës për tu angazhuar pranë ZK në këtë institucion
- 3.Pas miratimit të stafit pranë kësaj zyre do të filloj dhe funksionimi i rregullt i saj sipas planit të përcaktuar më parë.

ZK në këtë fakultet ka qënë e hapur më parë, dhe kishte një bashkëpunim të mirë me Zyrat e Karrierës në njësitë e tjera të UT. Kjo për faktin se, fillimisht ato kanë qënë nën strukturën e Rektoratit të UT dhe mes tyre ka pasur më shumë komunikim, dhe më pas u vendos që ato të përfshihen në strukturat e secilit prej fakulteteve, nëpërmjet Vendimit Nr.39, datë 04.04.2018 të Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës. Në pikën 2, shprehet mënyra e miratimit të strukturave për njësitë e UT, sipas një formulari tip do tu jepte mundësinë Fakulteteve që nëpërmjet vendimit të dekatit të ngrihet Zyra e Karrierës dhe të përpilohet një rregullore për funksionimin e saj. Për disa arsye ky vendim nuk është ndërmarrë nga dekanët e FDUT ndër vite, por çfarë mund të themi është se komunikim me FDUT do të jetë i vazhdueshëm deri në rihapjen e zyrës dhe funksionimit të saj. Njëkohësisht ky projekt do të vijojë duke asistuar fakultetin në krijimin e një fushate informuese për studentët mbi rëndësinë dhe punën e kësaj strukture, duke marrë në konsideratë formësimin e sugjerimeve të cituara në fund të punimit.



VËZHGIM NË UNIVERSITETET EUROPIANE

Pas studimit të modeleve të ndryshme të zyrave të karrierës në vend, lindi nevoja e referimit tek modelet ndërkombëtare, për të mësuar prej eksperiencës dhe punës së tyre. U përzgjedhën dy universitete: një europian, për të parë funksionimin e një universiteti pjesë të BE dhe rrjetit Erasmus +; dhe një universitet në territorin e Mbretërisë së Bashkuar, si përfaqësues i elitës së mësimdhënies britanike.

"UNIVERSITY OF EDINBURGH" EDINBURG, SKOCI

Universiteti publik i Edinburgut në Skoci, është një ndër universitetet më të mira në botë me një eksperiencë qindra vjeçare. Qasja në këtë universitet ka qënë vetëm online, por ekzaktësisht midis shumë universiteteve e kemi përzgjedhur, për faktin se faja web është e mirë organizuar dhe tepër informuese. Nëse shkojmë në faqen web të "University of Edinburgh", dhe ndalemi tek dritarja që përfshin shërbimet e karrierës, do të shohim se kemi një kombinim nën-ndarjesh ku secila prej tyre përfshin një nga elementët kyç në zhvillimin e karrierës. Përkatësisht nën-ndarjet janë:

- Studentët
- Të diplomuarit
- Stafi i universitetit
- Punëdhënësit
- Shërbimet që ofron Zyra e Karrierës
- Aktivitete dhe botime të përmuajshme(newsletter)

Në qoftë se përfshihemi më shumë në faqen web do të shohim se nën-ndarjet vijojnë duke dhënë informacione dhe shërbime specifike në varësi të target grupit për të cilin ofrohet. Përpos shërbimeve që ofrohen për studentët, shërbimi i karrierës ka një ekip dedikuar lidhjeve me punëdhënësit.

"Me një ekip të përkushtuar që synon të lehtësojë angazhimin student-industri." [1]

Si pjesë e strategjisë së tyre të përfshirjes së punëdhënësve, ata i japin përparësi krijimit të lidhjeve me sektorë, organizata dhe individë që janë në një shkallë të lartë harmonizimi me:

- Fushat e interesit të studentëve;
- Prioritetet akademike dhe tematike të vetë institucionit;
- Zonat e tregut të punës me fuqi dhe rritje të veçantë;
- Zonat e tregut të punës ku rrugët e hyrjes mund të jenë të vështira për t'u qasur.

[1] Shërbimi i karrierës, "Si bashkëpunojmë me punëdhënësit?" web-faqja e Universitetit të Edinburgut

“CENTRAL EUROPEAN UNIVERSITY” (CEU), VIENË, AUSTRI

CEU ofron një shembull tepër pozitiv për shërbimet e karrierës që ofron Zyra e Karrierës në këtë universitet. Përpos aksesimit online të faqes së universitetit kemi pasur mundësinë që ti drejtohemi kësaj zyre edhe fizikisht, për të parë konkretisht modelin që CEU ofron. Si fillim, shohim se edhe në faqen web të universitetit, seksioni i Karrierës, është i mirë organizuar dhe i ndarë në seksione.

“Zyra e Shërbimeve të Karrierës CEU mbështet studentët dhe të diplomuarit në përcaktimin e qëllimeve dhe përkufizimeve të tyre të suksesit dhe i ndihmon ata në marrjen e informacionit, aftësive dhe përvojave që rrisin zhvillimin e tyre personal, punësimin dhe suksesin në programet e tyre akademike.” [1]

Në shërbimet kryesore të karrierës përfshihen:

- Mësimi i aftësive thelbësore që duhen për të pasur një karrierë (të suksesshme)
- Ofrimi i konsultimeve individuale mbi karrierën
- Lehtësimi i lidhjeve me punëdhënës globalë dhe shpërndarjen e njohurive për vende të lira të punës
- Ofrimi i informacionit rreth sektorëve të ndryshëm të punësimit dhe rrugëve të karrierës
- Ofrimi i mbështetjes për të gjetur praktika dhe mundësi për financimin e tyre
- Ofrimi i materialeve online për zhvillimin e karrierës të përshtatura për nevojat e studentëve aktualë dhe studentëve të diplomuar.

Në faqe mund të gjenden lehtësisht edhe një grup ushtrimesh praktike, të formuluar në mënyrë të tillë për të ndihmuar studentët të kuptojnë interesat e tyre profesionale, si mund të vënë në praktikë dijet e mësuara në universitet me një tërësi profesionale.

Një tjetër element që vihet re është edhe shpjegimi dhe modele të ndryshme strukturimi CV-sh profesionale dhe letra motivimi, për studentët e nivelit Bachelor dhe Master. Zyra e Shërbimeve të Karrierës përditëson faqen me informacione nga punëdhënës, rekrutime dhe panairë të karrierës të organizuara jashtë universitetit. Lidhja me Alumni gjithashtu është prezente dhe ish-studentë herë pas here ndajnë eksperiencën e tyre me studentët aktualë. Çdo program studimi ka data bazën e tij të rrugëtimit profesional të të diplomuarve, duke krijuar kështu një ide më konkrete për studentët e rinj ose maturatët.

Dy universitetet e lartpërmenduar përfaqësojnë histori dhe mjete financiare në dispozicion, të ndryshme nga Universiteti i Tiranës, por duke ndjekur këtë shembull vlerësojmë se ekziston potenciali për të pasur zyra efektive karriere edhe në UT.

Një problematikë e ndeshur gjatë studimit ka qënë mungesa e dëshirës së studentëve për t'u angazhuar në Zyrën e Karrierës.

Vihet re se ekziston një mungesë informacioni tek studentët për shërbimet që kjo zyrë mund të ofrojë dhe dobishmërinë e saj.

Për të pasur efektivitet dhe informim të studentëve në lidhje me këtë zyrë, mund ti drejtohem si shembull CEU, ku prezantimi i stafit të Zyrës së Karrierës ishte pjesë e sesioneve orientuese të javës së parë të studimeve për studentët e vitit të parë. Gjithashtu në javën vijuese, çdo program studimi pati përsëri një sesion mbi shërbimet që zyra ofronte për çdo departament sipas elementëve specifikë që nevojiten. Në vijimësi studentët njoftohen për çdo aktivitet/seminar që Zyra zhvillon dhe në varësi të pjesëmarrjes së studentit, mund të vlerësohen edhe me çertifikata vlerësimi.

Elementë të tillë, si për shembuj artikuj ose postera se pse studentët duhet të vizitojnë dhe të marrin pjesë në aktivitetet e Zyrës së Karrierës mund të shihen edhe tek faqja web e Universitetit të Edinburgut.

Konsiderojmë se faktorët e lartpërmendur janë pozitivë dhe ndikojnë në efektivitetin e Zyrave të Karrierës.

SUGJERIME PËR FAKULTETET VENDASE

Në përfundim të vëzhgimeve dhe analizës së fakulteteve të sipër përmendura, punimi synon të nxjerr në pah një manual me pika kyçe për mirëfunksionimin e Zyrave të Karrierës për të qënë sa më pranë dhe në ndihmesë të studentëve. Duke marrë në konsideratë rihapjen dhe riorganizimin e Zyrën e Karrierës në FDUT, do të paraqiten disa propozime mbi bazën e të cilave kjo strukturë duhet të funksionojë.

1. Krijimin e një platforme komunikimi midis fakultetit dhe studentëve, fakultetit dhe partnerëve për marrjen e ofertave të punësimit ose/dhe praktikave të punës, dhe fakultetit dhe organizatave për krijimin e hapësirave bashkëpunuese mbi projekte dhe trajnime të ndryshme.
2. Organizimi i përvitshëm i panairove të karrierës si një urë lidhëse midis studentëve dhe punëdhënësve, universiteteve ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të projekteve.
3. Aksesit në informacion nga të gjithë të interesuarit dhe lehtësimin e marrjes së shërbimit nga ata me ndihmesë të teknologjisë dhe prezencës përmes workshopeve, seminareve dhe trajnimeve.
4. Sensibilizimi përmes takimeve të vazhdueshme që ZK duhet të ofrojë për angazhimin vullnetar të studentëve.
5. Bashkëpunime të vazhdueshme me strukturat simotra, në universitetet vendase e të huaja me qëllim përfitimin dhe ndarjen e eksperiencave për të ofruar një shërbim dinjitoz.
6. Krijimi i konkurseve brenda dhe jashtë stukturës universitare të cilat nxisin aftësitë komunikuese, kreative, organizuese.
7. Ofrimin e një hapësire për të ndarë ide inovatore dhe orientimin e tyre drejt realizimit me mbështetje të strukturave të fakulteteve dhe udhëheqje të pedagogëve.
8. Zhvillimi i ditëve orientuese në fakultet për çdo fillim viti akademik dhe çdo student të ri, përmes një rrjeti studentësh vullnetarë të cilët do të gjenden në ndihmesë të të sapoardhurve.
9. Motivimi për pjesëmarrje në aktivitete jashtëshkollore dhe pas përfundimit të vitit akademik si pjesëmarrje në SummerSchool, programe shkëmbimi, projekte ndërkombëtare.
10. Krijimi i rrjetit funksional Alumni, për ndarjen e eksperiencave dhe udhëzimin e studentëve.

PËRFUNDIME

Zyra e Karrierës është një nga zyrat më të rëndësishme në një fakultet/universitet. Për vetë shërbimet dhe ndihmën e madhe praktike që kjo zyrë ofron për studentët, qëllimi dhe dëshira jonë është tek **rivitalizimi i këtyre zyrave në Universitetin e Tiranës**.

Nga vlerësimi si fillim i bazës ligjore, dhe më pas monitorimet në fakultetet përkatëse, pjesë të UT, duhet të themi se është e nevojshme ti kushtohet shumë më shumë rëndësi Zyrës së Karrierës.

- Sugjerimi i parë është në lidhje me **plotësimin e vakancës ligjore**. Mungesa e një rregullimi specifik për Zyrat e Karrierës në rregulloret e brendshme të fakulteteve (në fakultetet në të cilat nuk kishin asnjë parashikim) ka rezultuar në performancën jo të mirë të parë në disa prej fakulteteve.
- Sugjerimi i dytë shkon për **aspektin promovues të kësaj zyre**. Kjo mungesë promovimi të shërbimeve të karrierës, dhe niveli të ulët ose shpesh herë edhe inekzistent të informimit të studentëve për funksionet e kësaj Zyre, është padyshim një faktor negativ. Këtu, mund të marrim shembullin e metodave që universitetet e huaja përdorin për të njohur studentët e tyre me këto shërbime dhe strategjitë e tyre promovuese për veprimtarinë e ZK.
- Një rol të rëndësishëm ka dhe punësimi i një **stafi të specializuar**, por pse jo edhe specializimi i stafit përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme. Ky një faktor që do të rriste nivelin e shërbimeve të ofruara nga këto zyra.
- Krijimi i një **rrjeti alumni** efektiv dhe sa më të gjerë do të ishte hapi i parë në suksesin e këtyre zyrave. Pjesëmarrja aktive në këto Zyra e studentëve me eksperiencë, ose dhe ish-studentëve, i ofron studentëve të ardhshëm informacione dhe të dhëna të dorës së parë mbi rrugëtimin e tyre gjatë dhe pas studimeve.

Nuk duhet të harrojmë se investimi dhe rëndësia që i kushtojmë arsimit sot, është një e ardhme më e mirë nesër.

FALENDERIME

Në përfundim të këtij studimi duhet të falenderojmë mbështetësit tanë dhe partnerët në realizimin e tij.

Falenderojmë **CLE - Centre for Legal Empowerment**, që bëri të mundur realizimin e tij, duke mbështetur dhe monitoruar implemetimin e tij gjatë të gjithë procesit.

Njëkohësisht, falenderojmë **dekanen e FDUT**, Prof.Asoc.Dr. Dorina Hoxha, për mbështetjen dhe gadishmërinë në relizimin dhe implementimin e propozimeve tona.

Në vijim i jemi mirënjohës **punonjësve pranë Zyrave të Karrierës** në çdo fakultet për bashkëpunimin në dhënien e informacionit përkatës.

- Autorët

Kontakt

Adresa Rruga Qemal Stafa, Tiranë

info@cle.al

www.cle.al // www.juristionline.al

